

Национален младински совет  
на Македонија




Пërgjigjet e pyetjeve të parashtruara më shpesh në lidhje me thirrjen për mbështetje financiare të ndërmarrjeve sociale

Numri i referencës: IPA/2021/427-552

drejtuar nga: *Këshilli Rinor Nacional i Maqedonisë*


financuar nga *Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup përmes Instrument for Pre-accession Assistance for Rural Development / EuropeAid/171244/DD/ACT/MK*



СОЦИЈАЛНО ПРЕТПРИЕМНИШТВО  
ЗА МЛАДИНСКО ВРАБОТУВАЊЕ



Финансирано од  
Европска Унија



**1. Lidhur me thirrjen për mbështetje financiare dua të informohem: a është e mundur për një kompani të re apo ekzistuese, a është e mundur me shoqatë qytetarësh.**

Në vetë thirrjen për mbështetje financiare për ndërmarrjet sociale, theksohen kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët e interesuar. Shikojeni në detaje pikën 5 të thirrjes, me titull " Llojet e aplikantëve ose kategoritë e aplikantëve që mund të marrin mbështetje financiare" ku thuhet:

*"Thirrja është e hapur për të gjitha ndërmarrjet sociale ekzistuese dhe të gjitha grupet joformale të të rinjve që kanë ide për të filluar një ndërmarrje sociale. Aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:*

- *Të punojë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;*
- *Të jetë i regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare ose Ligjin për shoqata dhe fondacione<sup>1</sup>;*
- *Të jetë një ndërmarrje sociale rinore;*
- *Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit, dhe mos veprojë si ndërmjetës."*

**2. Kemi themeluar kompani që synon ta zhvillojë si një ndërmarrje sociale, prandaj interesimi për thirrjen tuaj. Pyetja ime është, a është fusha 1 për krijimin e një ndërmarrje të re nga e fillimi? Sepse këto aktivitete do të ishin të parat në këtë NS që tashmë ekziston ndërsa do ta ndryshonim strukturën në rinore. Ideja e lançimit të një eko produkti me prodhim vendor mund të angazhojë të rinj nga kategoritë e rrezikuara. Në këtë mënyrë jemi të përshtatshëm për fushën e dytë.**


Në vetë thirrjen për mbështetje financiare për ndërmarrjet sociale thuhet se në fushën 1 një grup joformal të rinjsh mund të aplikojnë për të krijuar një ndërmarrje të re sociale. Shikoni në detaje pikën 4 të thirrjes, me titull " Temat prioritare të thirrjes" ku thuhet:

*"Për aplikantët e interesuar për fushën 1, është e rëndësishme të theksohet se nëse marrin njoftim se janë përzgjedhur për të marrë mbështetjen financiare, duhet të regjistrojnë subjekt juridik brenda një muaji nga njoftimi."*

**3. Në rezultatet e pritshme pika 2 Rritja e numrit të ofruesve të shërbimeve sociale gjithëpërfshirëse të udhëhequr nga të rinjtë; - na tërhoqi vëmendjen në veçanti, por duam ta kuptojmë dhe/ose më saktë nëse e kemi kuptuar saktë këtë rezultat. Nga këndvështrimi ynë, kjo është një mundësi vërtet e shkëlqyer nëse kjo i referohet ofruesve të shërbimeve sociale**

<sup>1</sup>Aplikantët e suksesshëm në Fushën 1 kërkohet që të plotësojnë kriteret brenda një muaji nga marrja e njoftimit





(Shërbimet që janë në fazën e zhvillimit në nivel shtetëror - si shërbimet për të moshuarit, asistentët personalë për personat me aftësi të kufizuara, kujdesi paliativ, etj.) për arsye se këto shërbime ofrojnë mundësi punësimi për të rinjtë me arsim FILLOR, që është një dukuri e shpeshtë në mesin e kategorive të rrezikuara sociale të të rinjve.

**Pra pyetja jonë është në këtë drejtim:**

- 1. Nëse ofruesit e shërbimeve sociale të udhëhequra nga të rinjtë është në kuptimin e arsyetimit (ju lutemi mos ngurroni ta formuloni saktë për ta bërë atë më të qashtëm për të gjithë në postim)?**

Vetë thirrja për mbështetje financiare të sipërmarrjeve sociale nuk e përcakton termin “shërbime sociale” për të ofruar hapësirë për ide të reja kreative dhe inovative që do të jenë unike dhe për rrjedhojë të kalueshme në tregun e lirë. Së këndejmi, i takon secilit aplikant të përcaktojë nëse do t'i konsiderojë shërbimet sociale nga prizmi i Ligjit për mbrojtje sociale apo nga një prizëm më i gjerë në mënyrë që të mbulohen edhe shërbimet që nuk janë të përcaktuara/parashikuara sipas këtij ligji.

- 4. A është "Fusha 2: zhvillimi i teknologjive inovative dhe avancimi i shërbimeve..." një mundësi më e gjerë për krijimin e idesë sonë të projektit që kombinon mundësitë për grupe të ndryshme të marginalizuara me modele të ndryshme për intervenime?**


Vetë thirrja për mbështetje financiare për ndërmarrjet sociale tregon se zona 2 është e fokusuar në “zhvillimi i teknologjive inovative dhe përmirësimi i shërbimeve të sipërmarrjeve sociale ekzistuese që ndihmojnë në përfshirjen dhe punësimin e të rinjve romë, të rinjve pa kujdes prindëror, të rinjve me aftësi të kufizuara, vajzave të reja, të rinjve të shëruar vartës të lëndëve narkotike”. Sa kategori të ndryshme të rinjsh me më pak mundësi do të përfshihen dhe nëse do të përdoren intervenime të ndryshme varet nga vetë aplikanti dhe nga qëllimi dhe rezultatet që synohen të arrihen përmes idesë së projektit.

- 5. A kam të drejtë për ndihmë sociale sepse jam e papunë dhe vajzë nga shtëpi për fëmijë pa prindër, 9 muaj më parë lindi fëmijën tim të dytë.**

Vetë thirrja ka për qëllim mbështetjen financiare të ndërmarrjeve sociale, dhe nëse ndërmarrjet sociale do të ofrojnë një model për mbështetje sociale për personat e papunë varet nga ideja e tyre e projektit. Qendra Ndërkomunale për Punë Sociale e Qytetit të Shkupit do t'ju japë një përgjigje më specifike për pyetjen tuaj.

- 6. Një vajzë 19-vjeçare hapi kompaninë e saj me mbështetje për vetëpunësim në nëntor. Pyetja ime është se si dhe çfarë duhet aplikuar për të përmirësuar dhe zhvilluar biznesin personal, përndryshe një dyqan veshjesh për femra.**





Nëse jeni të interesuar për fushën 2 të thirrjes për mbështetje financiare të ndërmarrjeve sociale, mund të lexoni më shumë informacion në fushën 4, me titull *"Temat prioritare të thirrjes"*, ku tregohet se: *"Fusha 2: zhvillimi i teknologjive inovative dhe përmirësimi i shërbimeve të sipërmarrjeve sociale ekzistuese që ndihmojnë përfshirjen dhe punësimin e të rinjve romë, të rinjve pa kujdes prindëror, të rinjve me aftësi të kufizuara, vajzave të reja, të rinjve- të shëruar vartës të lëndëve narkotike."*

7. **Organizata jonë ka krijuar kohët më parë SHPKNJO aktiviteti prioritar i së cilës është turizmi. A duhet të aplikojmë në projekt në emër të shoqatës apo në emër të kompanisë që tashmë është e regjistruar si SHPKNJP? Nëse aplikojmë në emër të kompanisë, a duhet të përfshihet edhe puna e organizatës në aspektin e formimit, përvojës, buxhetit, kapaciteteve. Me rastin e paraqitjes së dokumenteve referente, a duhet të paraqesim raporte nga kompania apo raporte nga organizata (fjala është për dy subjekte juridike, njëri si OJQ, tjetri SHPKNJP). A duhet të ndryshohet/shtohet aktiviteti prioritar i kompanisë gjatë marrjes së mundshme të projektit?**

Thirrja për mbështetje financiare për ndërmarrjet sociale tregon se është e mundur të aplikoni si SHPKNJP ashtu edhe si shoqatë, për të cilën shikoni me detaje pikën 5 të thirrjes, me titull *"Llojet e aplikantëve apo kategoritë e aplikantëve që mund të marrin mbështetje financiare"* ku thuhet:

*"Thirrja është e hapur për të gjitha ndërmarrjet sociale ekzistuese dhe të gjitha grupet joformale të të rinjve që kanë ide për të filluar një ndërmarrje sociale. Aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:*


- *Të punojë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;*
- *Të jetë i regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare ose Ligjin për shoqata dhe fondacione<sup>2</sup>;*
- *Të jetë një ndërmarrje sociale rinore;*
- *Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit, dhe mos veprojë si ndërmjetës."*

Gjithashtu, vetë thirrja në pikën 4 parashikon se i vetmi ndryshim që duhet bërë pas marrjes së mundshme të projektit është regjistrimi i personit juridik të grupeve informale, përkatësisht: *"Për aplikantët e interesuar për fushën 1, është e rëndësishme të theksohet se nëse marrin njoftim se janë përzgjedhur për të marrë mbështetjen financiare, është e nevojshme të regjistrojnë subjekt juridik brenda një muaji nga njoftimi."*

---

<sup>2</sup>Aplikantët e suksesshëm në Fushën 1 kërkohet që të plotësojnë kriteret brenda një muaji nga marrja e njoftimit





Çdo subjekt juridik që aplikon duhet të paraqesë sa këto **dokumente** vetakane, në pajtim me pikën 10 të thirrjes publike:

*Aplikimi për këtë thirrje për ata që aplikojnë për **fushën 2** përbëhet nga:*

- 1. Formulari i aplikimit (Aneksi 2);*
- 2. Formulari i propozim – buxhetit (Aneksi 3);*
- 3. Deklarata për financimin e dyfishtë (Aneksi 4);*
- 4. Gjendja aktuale nga Regjistri Qendror, jo më e vjetër se gjashtë muaj;*
- 5. Biografi të shkurtra të personelit të përfshirë në projekt;*
- 6. Raporti Vjetor Narrativ për punën dhe Raport financiar, për vitin 2021.*

- 8. Në cilën nga pyetjet tregojmë strukturën e organizatës/kompanisë? Meqenëse po flasim për SHPKNJ<sup>3</sup> të krijuar nga ne si pronar, nëse për organin drejtues sipas së cilit vlerësohet nëse është ndërmarrje rinore sociale ose nuk është rinore, tregohet se bordi drejtues i shoqatës ka 2/3 të rinj në strukturën e tij?**

Në vetë formularin e aplikimit, i cili është i qasshëm si pjesë e thirrjes për mbështetje financiare, struktura dhe ekipi i subjektit juridik aplikues mund të specifikohet në disa fusha. Aplikanti deklaron strukturën e tij dhe jo strukturën e organizatave/firmave/partnerëve simotra. E njëjta gjë mund të bëhet në "përshkrimin e shkurtër të organizatës" ose në "Informacione shtesë".

- 9. A mund të aplikoj?**

Ju mund të aplikoni nëse i plotësoni kriteret e pikës 5 të thirrjes, me titull "Llojet e aplikantëve apo kategoritë e aplikantëve që mund të përfitojnë mbështetje financiare", ku thuhet:

*"Thirrja është e hapur për të gjitha ndërmarrjet sociale ekzistuese dhe të gjitha grupet joformale të të rinjve që kanë ide për të filluar një ndërmarrje sociale. Aplikanti duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:*

- *Të punojë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;*
- *Të jetë i regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqëritë tregtare ose Ligjin për shoqata dhe fondacione<sup>3</sup>;*
- *Të jetë një ndërmarrje sociale rinore;*
- *Të jetë drejtpërdrejt përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e projektit, dhe mos veprjë si ndërmjetës.*

<sup>3</sup>Aplikantët e suksesshëm në Fushën 1 kërkohet që të plotësojnë kriteret brenda një muaji nga marrja e njoftimit

